


01.c

3916

PO

13 12 18



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Nacionalni Koordinator za Kulturu, Omladinu i Sport
National Coordinator for Culture, Youth and Sport



Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica
Municipality of Gjakova

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

KOORDINATORIT NACIONAL PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

dhe

KOMUNËS SË GJAKOVËS

për avancimin e pozitës së të rinjve në sport, kreativitet kulturor dhe mendim kritik si
dhe në dituri

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komuna e Gjakovës (tutje
referuar si palët):

Duke njohur nevojën për përmirësimin e të kuptuarit të nevojave të rinisë në
Kosovë,

Duke pasur parasysh rolin kyç që duhet të luajnë institucionet më të larta
shtetërore në ofrimin e kushteve për rininë e vendit,

Me dëshirën për të përforcuar bashkëpunimin ndërinstitutional dhe duke besuar
se ky bashkëpunim do t'i shërbejë interesit të përbashkët të të dyja
institucioneve,

Pajtohen si më poshtë:

Neni I

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është përcaktimi i angazhimeve të
ndërsjella të palëve në realizimin e projekteve konkrete në fushën e kulturës, rinisë dhe
sportit në Republikën e Kosovës.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi synon përforcimin e kapaciteteve intelektuale, kulturore
e sportive të rinisë kosovare, si dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në fusha
të interesit të përbashkët të të dyja palëve.

Neni II

Fushat e bashkëpunimit

Secila palë, duke iu përmbajtur detyrave dhe qëllimeve të përcaktuara me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës, pajtohet që të inkurajojë dhe promovojë bashkëpunimin në këto fusha:

- (a) Shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen e ndërsjellë për projektet rreth rinisë, kulturës dhe sportit;
- (b) Aranzhimin e përbashkët të aktiviteteve që kanë për synim grumbullimin e donacioneve ndërkombëtare për projektet që promovojnë kulturën dhe sportin;
- (c) Angazhimin e përbashkët rreth ecurisë dhe mbajtjes së garave sportive, të diturisë dhe kreativitetit kulturor si në nivelin shkollor, komunal dhe atë qendror;
- (d) Ndërhyrjen në infrastrukturën sportive duke ofruar bashkëpunim në zhvillimin e garave.

Neni III Obligimet e palëve

Në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje, duke iu përmbajtur kompetencave të përcaktuara ligjore, palët obligohen që të bashkëpunojnë dhe asistojnë njëra tjetrën për implementimin e projekteve të përbashkëta të parapara në këtë marrëveshje, si në vijim.

Secila palë obligohet që me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në Nenin 2, të ofrojë bashkëpunimin dhe mbështetjen profesionale, logjistike dhe asistencë financiare për implementimin e projekteve nga fushat e parapara të bashkëpunimit.

Brenda përcaktimeve ligjore, palët gjithashtu obligohen që të ofrojnë mbështetjen e tyre duke ushtruar kompetencat për të siguruar implementimin e projekteve dhe qëllimeve të përbashkëta të marrëveshjes.

Obligimet e Komunës përkatëse

Siguron pajisje e mjete të nevojshme sportive për realizimin e garave sportive në sportet përkatëse si futsall, volejboll, basketboll, shah dhe atletikë.

Siguron transportin e nxënësve që marrin pjesë në garën, shkollore, komunale dhe atë në nivel vendi;

Siguron shfrytëzimin e shtëpive të kulturës me të gjitha pajisjet e tyre për realizimin e aktiviteteve kulturore me nxënësit e cila garë do të realizohet nga zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;

Siguron hapësirë pune për nënkoordinatorin rajonal.

Obligimet e Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport do të kujdeset për realizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore në komunën përkatëse duke bashkëpunuar me sektorët përkatës brenda komunës.

Do të kujdeset në mbarëvajtjen e aktiviteteve përkatëse duke siguruar që të gjitha aktivitetet sportive dhe kulturore të realizohen pa e penguar procesin mësimor dhe duke respektuar legjislacionin përkatës.

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport do të ndihmojë Komunën përkatëse në sigurimin e pajisjeve specifike të cilat janë të domosdoshme në realizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore.

Neni IV

Shtojca numër 1

Pjesë e kësaj marrëveshjeje do të jetë edhe shtojca numër 1 e cila është e bashkangjitur në fund të kësaj marrëveshjeje.

Neni V

Implementimi

Në implementimin e kësaj marrëveshjeje, nëpërmjet organeve gjegjëse, palët duhet të menaxhojnë dhe promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellët.

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e obligimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnerë në bashkërendimin e të gjitha nismave që do të garantojnë zbatimin, institucionalizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë marrëveshje.

Neni VI

Rishikimi, modifikimi dhe amandamentimi i marrëveshjes

- (1) Secila nga palët mund të kërkojë rishikimin, modifikimin dhe amandamentimin e marrëveshjes nëpërmjet një kërkesë me shkrim.
- (2) Secili ndryshim i marrëveshjes duhet të bëhet në të shkruar, duhet të nënshkruhet nga të dyja palët, dhe të integrohet brenda kësaj marrëveshjeje
- (3) Hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve dhe amandamenteve duhet të hyjë në fuqi sipas marrëveshjes së palëve.

Neni VII

Këshillimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- (1) Palët pajtohen që në mënyrë periodike apo me kërkesë të njërës palë të raportojnë për implementimin e projekteve dhe zhvillimin e bashkëpunimit.
- (2) Në rast të mosmarrëveshjes, palët dakordohen që mosmarrëveshjen ta zgjidhin nëpërmjet negocimit dhe organeve kompetente brenda Republikës së Kosovës.

Neni VIII

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.


Ndërprerja e njëanshme e marrëveshjes mund të bëhet vetëm pasi pala që dëshiron të tërhiqet ta njoftojë palën tjetër me shkrim për qëllimin e tërheqjes, të paktën tre muaj para se të bëhet tërheqja.

Nëse nuk dakordohet ndryshe, asnjëra palë nuk ka të drejtë të tërhiqet nga bashkëpunimi gjatë kohës kur është duke u bërë implementimi i ndonjë projekti specifik pa përfundimin e atij projekti.

Nënshkruar në Gjakovë, më datë 12/12/2018 në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë.

Koordinatori Nacional për
Kulturë, Rini dhe Sport

Rexhep Hoti



Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini



Shtojca numër 1

Mjetet e nevojshme për Garën në Sport	Mjetet e nevojshme për Kreativitetin Kulturor dhe Mendimin Kritik	Mjetet e nevojshme për Garën e Diturisë
1.Pajisje me rrjeta të Volejbollit	1. Shfrytëzimi i shtëpive të kulturës (përdorimi i të gjitha pajisjeve brenda teatrove: zërimi, pajisjet për zhvillimin e dramave etj.)	1.Transporti i nxënësve për garat në nivelin republikan
2.Topa për Volejboll	2.Transporti i nxënësve për garat në nivelin komunal dhe republikan	
3. Pajisje për Atletikë, medicinboll		
4. Tabela për Shah		
5.Pajisje me rrjeta të golave		
6.Topa për Futsall		
7.Transporti i nxënësve për zhvillimin e ligave (kur disa shkolla e formojnë një ligë)		
8.Transporti i nxënësve për garat në nivel republikan në sport		